



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë  
Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 (a) të Ligjit për ratifikim të Marrëveshjes mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian për rregullat për bashkëpunim në lidhje me ndihmën financiare nga KE të Republikës së Maqedonisë dhe realizimit të ndihmës sipas komponentit V (IPARD) nga instrumenti për ndihmë paraqasëse ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 165/2008) dhe në bazë të Pjesa V paragrafi (5) të Programit për shfrytëzim të mjeteve nga Instrumenti për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 93/2013),

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

më 27 tetor 2014 publikon

**THIRRJE PUBLIKE nr. 02/2014**

Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (në tekstin e mëtutjeshëm Agjencia) si institucion kompetent dhe organ kontraktues për implementimin e Instrumentit për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të BE (IPARD) fton të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike nga Republika e Maqedonisë të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 për masat në vijim:

**Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian**

**Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian**

**Masa 302 – Diverzifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale**



**Instrument për ndihmë parahyryëse për zhvillim rural të Unionit Evropian  
(IPARD) 2007-2013**





**1. Përkrahja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë prej 75% mjete të siguruara nga komponenti i pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD), në përputhshmëri me Marrëveshjen financiare shumëvjeçare 2007-2011 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.**

**2. Mjete financiare për kërkesë individuale** jepen si përkrahje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej 50% nga vlera e harxhimeve të pranueshme. Përkrahja financiare për masën 101 mund të ketë:

- 55% të vlerës së harxhimeve të pranueshme për bashkëfinancim të investimeve të ekonomive bujqësore bartës i së cilës është në moshën prej 18 deri 40 vjet në ditën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve sipas masës 101.
- 60% të vlerës së harxhimeve të pranueshme për bashkëfinancim të investimeve të ekonomive bujqësore në rajonet malore
- 65% të vlerës së harxhimeve të pranueshme për bashkëfinancim të investimeve të ekonomive bujqësore në rajone malore dhe bartës i të cilit është në moshën prej 18 deri në 40 vjet në ditën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve sipas masës 101.
- 75% për projekte investuese të realizuara në rajone ku Komisioni ka përcaktuar se kanë ndodhur fatkeqësi të jashtëzakonshme natyrore ose për investime të ekonomive bujqësore me qëllim të realizimit të direktivës nitrare për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat që rrjedhin prej bujqësisë që është lëndë e ekzistimit të strategjisë nacionale.

**3. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 10 dhjetor 2014.**

**4. Tërheqja e formularëve dhe udhëzuesve:**

Formularët e nevojshëm për “Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2007-2013” si dhe “Udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2007-2013” në të cilët janë të përmbajtur të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për financim dhe informatat tjera të cilët janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist, Udhëzues për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në versionin elektronik mund të merren nga ueb-adresa e Agjencisë: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e shtypura prej kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 si dhe udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2007-2013 mund të merren drejtpërdrejt në Agjencisë në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural  
bul. 3 - ta Makedonska Brigada nr 20. (ndërtesa Makedonija Tabak, bloku C),  
1000 Shkup**

dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësi rajonale të **Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi** çdo ditë pune prej orës **8:30 deri më 16:30**. (Lista qendrave rajonale apo njësi punuese të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhëna për kontakt është e shpallur në ueb-adresën [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)).

**5. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:**

Kërkuuesi duhet të plotëson dhe të dorëzon Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 për masë individuale, Plan Afarist të përgatitur sipas Udhëzuesit për përgatitjen e Planit Afarist dhe





dokumentacionit të shoqëruar siç është e cekur në Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013. Informata më detaje për kërkesat specifike për pranueshmëri janë të specifikuara në Udhëzuesin për shfrytëzuesit e mjeteve na IPARD Programi 2007-2013.

Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 dhe Plani Afarist përpunohen në gjuhën maqedone.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 së bashku me Planin Afarist dhe dokumentacionin e përgjithshëm të nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm "MOS E HAP" për Thirrjen Publike 02/2014 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në recepcionin e Agjencisë.

**Vërejtje:** Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013, Plani Afarist dhe dokumentacioni i dorëzuar NUK KTHEHEN. Për kryerjen e kontrollit në teren nga ana e Agjencisë duhet që kërkuesi të ketë në vetvete kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuara deri te Agjencia.

Informata më detale në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb-faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

